



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

Datë: 14.05.2020

Pyetjet nga Aplikantët/Përgjigjjet nga MZHR-ja lidhur me PZHRB 2020

1. Lidhur me Skema e Granteve „Programi i Zhvillimit Rajonal të Balansuar“ PZHRB 2020 (Lot I, Lot II dhe Lot III), me duhet të dije nëse veprimtaria e restorantit ka të drejte aplikimi, përkatësisht për blerjen e pajisjeve të kuzhinës si furra, grill, fërteze, etj?
- *PO keni të drejtë.*
2. Biznesi jonë është ekzistues dhe bënë pjesë në LOT 2?
- *Nëse jeni biznes ekzistues dhe keni qarkullim mbi 5,001.00 € dhe më pak se 15,000.00 € të deklaruar në ATK për v.2019 mund të aplikoni për Lot 2 (shih pikën 1.4 të udhëzuesit për aplikonte PZHRB 2020).*
3. A lejohën kostot e pakualifikueshme sepse është konfuze të kjo pjesë. Edhe pse theksohet kosto të pakualifikueshme shkruan nuk guxojnë të tejkalojnë 20 %. P.sh pagat e punëtoreve a munden me u shti te 20 %?
- *Kostot e pakualifikueshme nuk lejohen por nëse ato figurojnë në projektin e juaj dhe të njëjtat arrijnë shumën mbi 20 të vlerës së projektit aplikacioni refuzohet.*
4. Nëse kostot e pakualifikueshme arrijnë shumën mbi 20% të vlerës së projektit aplikacioni refuzohet. Shpenzimet e papranueshme janë çështje e përfituesit, prandaj ato nuk duhet të përfshihen në kërkesën për pagesë, kështu që përfituesi duhet të ketë mjete financiare vetanake për mbulimin e tyre?
- *Kostot e pakualifikuara nuk duhet të jenë pjesë e projektit.*
5. Vlera totale dhe vlera e financimit nuk duhet të tejkalojnë vlerën kryesore. A do të thotë se 30000 duhet te jete komplet totali apo 30.000 ministria dhe 10 shembull aplikuesi?
- *Në rastin konkret për Lot 3 duhet të jetë maksimum 30,000.00 financimi nga MZHR plus 10 % deri në 40% e vlerës totale të projektit bashkëfinancim nga aplikanti potencial.*
6. A e përkrah grandit sektorin e prodhimit, konkretisht prodhimin e ushqimit (kulaçeve) për bletë?
- *PO prodhimi i produkteve ushqimore është i kualifikuar.*

7. Thirrja për propozime për start-up dhe biznese ekzistues; Skema e Granteve „Programi i Zhvillimit Rajonal të Balancuar“ PZHRB 2020, tek: UDHËZUESI PËR APLIKANTËT E GRANTEVE MZHR/2020, në faqen katër ndër tjera thuhet citoj; “Sqarim: Sipas kategorizimit të ATK-së dhe sipas Ligjit Nr. 04/L-220 për Investime të Huaja, ndërmarrjet mikro dhe të vogla kategorizohen:
- a. Ndërmarrjet mikro prej 0-9 punëtor;
 - a. Ndërmarrjet e vogla prej 10-49 punëtor.”
- Pyetja e jonë konkrete është kjo: Kur një aplikant ka më shumë se 49 punëtor a i lejohet të aplikoj me projekt në këtë thirrje, edhe pse i plotëson kriteret tjera të dhëna tek kjo thirrje?
- *Kjo skemë është e dedikuar vetëm për bizneset mikro dhe të vogla d.m.th maksimumi 49 punëtorë të deklaruar në ATK për vitin e fundit fiskal, nëse ky numër tejkalohet nuk keni drejtë të aplikoni.*
8. A kam të drejtë për aplikim edhe këtë vit, pasi unë kam përfituar nga MZHR vitin 2019?
- *JO (shih pikën 3.1. të udhëzuesit për aplikantë PZHRB 2020).*
9. Një pyetje rreth Lotit 1, ndërmarrjet mikro dhe të vogla, sa i përket shumës së grantit. Pyetja është kjo: a mundet projekti me qenë ma i lartë se sa 5,000 euro, p.sh me qenë 6,500 euro? Ku pjesa prej 1,500 është bashkëfinancimi ynë, ndërsa 5,000 është pjesa e grantit? Apo duhet komplet projekti të jetë 5,000, ku pjesa e bashkëfinancimit është 10-40% e shumës prej 5,000?
- *Shiko me poshtë shembullin:
LOT 1 (startup) dhe LOT 1, (Biznes ekzistues) - minimumi i bashkëfinancimit 555.50 (10%) + kontributi i MZHR-së 5,000.00 (90%) = 5,555.50 vlera totale e projektit, ose maksimumi i bashkëfinancimit 3,333.00 (40%) + kontributi i MZHR-së 5,000.00 (60%) = 8,333.00 vlera totale e projektit*
10. Po ju shkruaj për një pyetje në lidhje me Grantet nga MZHR për Biznese të vogla. Nga investimet që nuk financohen, gjatë leximit të udhëzimit e pash që nuk financohet blerje e automjeteve të transportit dhe për këtë pikë desha të ju pyes, a është parapare të financohet blerja e pajisjeve të transportit për qëllime biznesi siç janë Autobusët për udhëtar, kombibuset etj, për zgjerim biznesi?
- *JO nuk financohet (shih pikën 2.7 të udhëzuesit për aplikantë PZHRB 2020).*
11. Lidhur me skemën e grantit të hapur nga MZHR "PZHRB 2020" - LOT 3, biznesi ynë është në përpunimin e tekstilit, për të cilin përveç makinerisë ne kemi nevojë edhe për një softuerë për shitjen online të produkteve tona i cili në baze të ofertës që kemi pranuar kap vlerën prej 8,000 EUR. E kemi parasysh që investimet në softuerë lejohen, por nuk është e qarte nëse ne na lejohet një softuerë i tillë për shitje. Ju lutem që të na njoftoni nëse kjo lejohet?
- *PO shih pikën 2.6 të udhëzuesit për aplikantë PZHRB 2020).*
 -
12. Duke ju referuar thirrjes suaj për propozime PZHRB 2020 , konkretisht LOT 3
Pyetja për Sqarim është :
- Pika 1.5 Shuma e Granteve (lot 3) është nga 15,001 deri 30,000€ , kërkesa për sqarim është që këto shuma paraqesin vlerën maksimale të grantit apo e projektit
- Pra nëse rastin tonë vlera e projektit është 45,000€ , a mund ne të kërkojmë 30,000€ (grant 66.67%) ndërsa bashkëfinancimi jonë të jetë 15,000€ (33.33%),
- *PO, shiko me poshtë disa shembuj:*
 - *LOT 1 (startup) dhe*

- *LOT 1, (Biznes ekzistues) - minimumi i bashkëfinancimit 555.50 (10%) + kontributi i MZHR-së 5,000.00 (90%) = 5,555.50 vlera totale e projektit*
maksimumi i bashkëfinancimit 3,333.00 (40%) + kontributi i MZHR-së 5,000.00 (60%) = 8,333.00 vlera totale e projektit
 - *Loti 2 - minimumi i bashkëfinancimit 1,666.00 (10%) + kontributi i MZHR-së 15,000.00 (90%) = 16,666.00 vlera totale e projektit*
maksimumi i bashkëfinancimit 10,000.00 (40%) + kontributi i MZHR-së 15,000.00 (60%) = 25,000.00 vlera totale e projektit
 - *Loti 3 - minimumi i bashkëfinancimit 3,333.00 (10%) + kontributi i MZHR-së 30,000.00 (90%) = 33,333.00 vlera totale e projektit*
maksimumi i bashkëfinancimit 20,000.00 (40%) + kontributi i MZHR-së 30,000.00 (60%) = 50,000.00 vlera totale e projektit
13. Përshëndetje. Dëshiroj të beje dy pyetje në lidhje me aplikimin për: Skema e Granteve "Programi i Zhvillimit Rajonal të Balancuar" PZHRB 2020:
- a. Në lidhje me piken ku kërkohet të paraqitet qarkullimi vjetor në aplikacion, ju lutem konfirmojeni se nga cili dokument i ATK-se SPECIFIKISHT duhet të referohemi në si aplikues? Gjithashtu, cilës rubrike të atij dokumenti duhet t'ju referohemi saktësisht? Për shembull: dokumenti "FORMULARI I DEKLARIMIT VJETOR DHE PAGESËS PËR TATIMIN NË TË ARDHURAT E KORPORATAVE" i lëshuar nga ATK në pikën [60] Të ardhurat bruto i specifikon të ardhurat bruto. Ju lutem na e sqaroni se cilit dokument dhe cilës rubrike duhet t'ju referohemi në tani si aplikues? (e kuptoj që vërtetimi kërkohet vetëm për ata që përzgjidhen si përfitues, mirëpo dëshirojmë që tani të sigurohemi që informatat në aplikacionin tonë janë plotësisht të sakta, në rast se përzgjidhemi si përfitues, dhe dokumentin që na e kërkoni, të jetë në përputhshmëri me informatat në aplikacion).
 - *Mund të dëshmohet me Vërtetimin tatimor që e dëshmon qarkullimin e biznesit për vitin e fundit fiskal të lëshuar nga ATK, ose përmes Formularëve të deklarimit vjetor nga ATK.*
 - b. Oferta për makinerinë / pajisjet: natyrisht aplikacionin tone do ta përpilojmë në gjuhën Shqipe, mirëpo a pranohet nëse oferta nga prodhuesi i makinës është në gjuhën Serbe ose Angleze?
 - *PO pranohet.*
14. Po ju kontaktoj lidhur me thirrjen për Grante, jam në proces të kompletimit të aplikacionit të grantit mirëpo kam një pyetje tek pasqyra buxhetore. Unë i përkas kategorisë së parë "Lot 1- Start Up".
Sa i përket pyetjes, duke u bazuar në planin për biznes të cilin e kam zhvilluar së bashku me koleget, shpenzimet për investim e kalojnë shumen prej 5 000 euro, a duhet që në listën e shpenzimeve të përfshijë të gjitha shpenzimet dhe pjesën që e kalon shumën e lartpërmendur dhe ta theksoj në faqen e dytë si bashkëfinancim apo duhet që të reduktoj shpenzimet dhe vetëm pajisjet deri në 5000 euro të përfshijë në aplikacion.
- *Te gjitha shpenzimet e lejuara duhet të përfshihen në vlerën totale të projektit duke e respektuar shumën e bashkëfinancimit 10-40 % (shih pikën 1.5 të udhëzuesit për aplikantë PZHRB 2020).*
15. Po ju shkruaj nga një kompani prodhuese në Kosovë. Rreth aplikimit në sistemin SMAED për thirrjen për grante, nuk po mund të regjistrohem në sistemin me emër të pronarit të biznesit pasi që sistemi nuk po e verifikon numrin personal dhe emrin e aplikuesit. Bashkangjitur gjeni foton e dëshmisë. Ju lutem me udhëzoni se cilat hapa duhet marrë në mënyrë që të regjistrohem.

- *Aplikimi duhet të bëhet nga pronarët e bizneseve apo personat e autorizuar siç figurojnë në ARBK*
16. Jam nga kompania projektuese XXXX. dhe si biznes i plotësojmë kushte që të aplikojmë në LOT 1 të kategorisë „Biznes ekzistuese“. Sipas udhëzuesit thuhet qe për këtë kategori grande për te cilën duhet te aplikoj aplikuese është me vlerë prej 2000-5000 euro. Kështu që dëshirova të informohem saktësisht për buxhetin për të cilën me lejohet të aplikoj, përkatësisht nëse me lejohet të aplikoj me një propozim për 5000 euro duke i shtuar vlerën e bashkëfinancimit prej 20 % (1000 euro) qe i bie të bëhet propozimit me vlerë gjithsej prej 6000 euro apo duhet të jetë vlera e bashkëfinancuar brenda shumës 5000 euro.
 - *Vlera maksimale e financimit për LOT 1 është 5,000.00 € dhe kësaj duhet ti shtohet bashkëfinancimi 10-40% (shih pikën 1.5 të udhëzuesit për aplikantë PZHRB 2020).*
 17. Ju lutem a ka mundësi të kemi me të qarte se cilët sektor kane të drejtë te aplikojnë ne këtë skem te granteve.
 - *Shih pikën 2.4 të udhëzuesit për aplikantë PZHRB 2020.*
 18. Unë kam aplikuar edhe vitin e kaluar për grant në ministrinë tuaj mirëpo njoftimi nuk është bërë përmes platformës smaed, siç është premtuar, por keni bërë publikim ne ueb faqen tuaj. Këtë vit a do te jetë e njëjtte apo do të na informoni përmes platformës.
 - *Njoftimi për dorëzimin e aplikacionit do të jetë përmes platformës SMAED, kurse rezultatet e aplikantëve të gjitha publikohen në ueb faqen e MZHR-së, sipas orarit indikativ të publikuar në ueb faqe.*
 19. Po ju shkruaj lidhur me grantet që po ofrohen te kategorizuara si LOT 1,2,3. A mundemi te aplikojmë për këtë grant bizneset ekzistuese si barnatore bujqësore dhe tregtia me pakice e mallrave te reja në dyqane të specializuara?! Me konkretisht aplikimi me u bë për softuerë kontabiliteti dhe pajisja teknologjike per rritje te biznesit?!
 - *Shih pikën 2.4 dhe 2.6 të udhëzuesit për aplikantë PZHRB 2020.*
 20. Unë si biznes kam qarkulluar gjithë 2019 me zero, dhe nuk kam te punësuar, me qenese biznesi është individual, a njehëm unë si i punësuar (vetëpunësuar), pra a ekziston mundësia per aplikim.
 - *Ekziston mundësia për aplikim (shih pikën 1.4 të udhëzuesit për aplikantë PZHRB 2020).*
 21. Dëshiroj të aplikoj në "Skema e Granteve „Programi i Zhvillimit Rajonal të Balancuar“ PZHRB 2020 konkretisht Lot I (startup). Tek pjesa ku shkruan dokumente shtese shkruan Oferta për makinerinë apo pajisjet/shërbimet e planifikuara në projekt për vlerën totale të projektit (oferta duhet të përmbaj të dhënat e sakta të ofertuesit dhe nuk duhet të jetë më e vjetër se data e shpalljes së thirrjes për propozime). A mund te ma sqaroni se çfarë duhet te vendosi këtu.
 - *Duhet të bashkëngjitet oferta për makinerinë apo pajisjet/shërbimet e planifikuara në projekt për vlerën totale të projektit.*
 22. Meqenëse propozimi i grandit duhet të përmbaj vlerën prej 2000-5000 euro, dëshirova të qartësoj nëse shuma e theksuar është shume ku përfshihet edhe pjesa e bashkëfinancuar apo i lejohet aplikuesit të aplikoj për grant me vlerë prej 5000 euro duke ju shtuar kësaj vlere edhe vlerën e

bashkëfinancimit që në rastin tim do ishte 20% me një shume totale prej 1000 euro dhe në këtë rastë i bie që mekanizma apo pajisjet të ofertuar të jenë me vlerë prej 6000 euro.

- *Vlera maksimale e financimit për LOT 1 është 5,000.00 € dhe kësaj duhet ti shtohet bashkëfinancimi 10-40% (shih pikën 1.5 të udhëzuesit për aplikantë PZHRB 2020).*
- *Shembull:*

LOT 1, (Biznes ekzistues) - minimumi i bashkëfinancimit 555.50 (10%) + kontributi i MZHR-së 5,000.00 (90%) = 5,555.50 vlera totale e projektit

maksimumi i bashkëfinancimit 3,333.00 (40%) + kontributi i MZHR-së 5,000.00 (60%) = 8,333.00 vlera totale e projektit

23. Jam pronarë e një mikro biznesi në Kosovë. Biznesi im vepron në fushën e bletarisë (bujqësi). Me sa lexova në shpalljen e grantit nga MZHR bizneset të cilat operojnë në fushën e bujqësisë nuk kanë të drejtë të aplikojnë përveç për ndonjë pajisje për përpunimin apo prodhimin e produktit. Pyetja ime është: Unë dua të aplikoj për një makineri të nevojshme për prodhimin dhe përpunimin e mjaltës, a financon ministria aplikime të tilla?

- *PO, (shih pikën 2.4 të udhëzuesit për aplikantë PZHRB 2020).*

24. Kam një pyetje në lidhje me Dokumentet tjera shtesë

- Vërtetim tatimor (jo më i vjetër se data e shpalljes së thirrjes për propozime) me të cilën vërtetohet se aplikuesi nuk ka borxhe aktuale tatimore të pashlyera apo obligime tjera tatimore, ose është në marrëveshje për shlyerjen e borxhit me ATK (mund të nxjerrët online nga ueb faqja e ATK-së); Vërtetimi tatimor nëse e shkarkojmë tani rezulton se personi është i regjistruar në ATK dhe ka borxhe tatimore apo obligime tjera tatimore të pa shlyera, realitet në nuk kemi obligime tatimore mirëpo me vendim të Qeveris ATK-ja ka shty deklarimin dhe pagesën për obligime tatimore –ky është shkaku që në vërtetimin tatimor rezulton se kemi obligime.

Ky problem shfaqet edhe në Aplikimin për aktivitete të prokurimit mirëpo KRPP lidhur me këtë problematik ka nxjerr një Vendim me të cilin lejon që kompanitë krahas Vërtetimit tatimor të japin një deklaratë nën betim që nuk jemi në vonës me pagesën e tatimeve përveç atyre që ndërlihen me Pandeminë Covid-19 dhe janë shtyre afatet e deklarimit dhe pagesës nga Qeveria e Kosovës. Pyetja: a pranohet vërtetimi tatimor duke e bashkangjitur deklaratën nën betim siç u cek më lart.

- *Shih pikën 3.1. të udhëzuesit për aplikantë PZHRB 2020 Vërtetim tatimor (jo më i vjetër se data e shpalljes së thirrjes për propozime) me të cilën vërtetohet se aplikuesi nuk ka borxhe aktuale tatimore të pashlyera apo obligime tjera tatimore, ose është në marrëveshje për shlyerjen e borxhit me ATK.*

25. Ju lutem nëse keni mundësi të më informoni se a kanë mundësi aplikim për grant ndërmarrjet që ofrojnë shërbime në energji solare, që kanë qarkullim vjetor mbi 1 milion.

- *Shih pikën 1.4 dhe 2.6 të udhëzuesit për aplikantë PZHRB 2020.*

26. Kemi filluar hapjen e një fabrike për prodhimin e pijeve alkoolike (Distileri), kemi regjistruar biznesin në ARBK, ATK, etj. dhe duke shikuar skemën e granteve 2020 tek MZHR saktësisht :

Loti 1 3 \Ndërmarrje mikro dhe të vogla (Qarkullimi minimum 0.00 deri 5.000 Euro të dëshmuara nga ATK), pyetja ime është :

- a. A mund të aplikoj për grant për një kazan për distilim të alkoolit ?
- b. A mund të aplikoj për grant për mbushtore të shisheve të alkoolit ?

- *PO, Shih pikën 2.6 të udhëzuesit për aplikantë PZHRB 2020.*

27. Gjate leximit të udhëzuesit për aplikim për grante, kam hasur ne disa paqartësi dhe kam disa pyetje për sqarim:
- Tek pika 2.1, thoni se për tu kualifikuar për grant duhet te jete ndërmarrje ne pronësi 100% private, ju lutem me sqaroni nëse kjo do të thotë që bizneset duhet të jenë biznese individuale e jo p.sh shpk sepse pronësi 100% private kane vetëm bizneset individuale.
- *Biznesi mund të jetë individual apo sh.p.k.*
 - "gjithashtu kontributi në natyrë nuk konsiderohet bashkëfinancim" , ju lutem me sqaroni se çka d.m.th "kontributi ne natyrë".
 - Një kontributi në natyrë është një kontribut i një të mire apo një shërbimi tjetër përveç parave.*
 - "Nëse kostot e pakualifikueshm e arrijnë shumën mbi 20% të vlerës së projektit aplikacioni refuzohet", a do të thotë kjo që kemi të drejte të paraqesim kosto te pakualifikueshme deri ne vleren 20% të vlerës së projektit apo nuk kemi të drejte fare të paraqesim në aplikim kosto që nuk kualifikohen ?
 - *Shih pikën 2.7 të udhëzuesit për aplikantë PZHRB 2020. Kostot e pakualifikuara nuk duhet të jenë pjesë e projektit, por nëse ato paraqiten në projekt dhe kalojnë vlerën 20% të projektit atëherë diskualifikoheni.*
28. Kemi një pyetje në lidhje me aplikimin për grant.
- Tek Lot 1 për biznese e keni ceke qe mund te kërkojmë nga 2,000-5,000 euro dhe kërkesa jonë për sqarim është kjo:
- P.sh nëse ne kërkojmë 5,000€, atëherë shuma prej 5,000€ a duhet të përfshije edhe bashkëfinancimin apo ju na ndihmoni me 5,000 dhe ne duhet ti shtojmë kësaj vlere edhe bashkëfinancimin nga ana jone ?
- *Vlera maksimale e financimit për LOT 1 është 5,000.00 € dhe kësaj mund ti shtohet bashkëfinancimi 10-40% (shih pikën 1.5 të udhëzuesit për aplikantë PZHRB 2020).*
 - *Shembull:*
LOT 1, (Biznes ekzistues) - minimumi i bashkëfinancimit 555.50 (10%) + kontributi i MZHR-së 5,000.00 (90%) = 5,555.50 vlera totale e projektit
maksimumi i bashkëfinancimit 3,333.00 (40%) + kontributi i MZHR-së 5,000.00 (60%) = 8,333.00 vlera totale e projektit
29. Dëshëm të ju pyesim lidhur me skemën:
- A mundemi ne si fabrike për përpunimin e mishit (SHPK Buçuku) të aplikojmë në këtë skemë. Ne jemi përfitues i skemës me MBPZHR por nuk e kemi të qarte se a mundemi të aplikojmë edhe ne këtë skeme pasiçë përpunimi i mishit nuk është aktivitet klasik i bujqësisë. Projekt propozimi jone do të jetë saktësisht çka kërkohet tek ju - blerja e makinerisë për prodhim, krijimi i vendeve te reja te punës si dhe rritja e eksportit.
- *Shih pikën 2.6 të udhëzuesit për aplikantë PZHRB 2020.*
30. Përshëndetje kam një pyetje për sqarim Biznesi im Operon qe (6) vite , a me lejon te aplikoj për një makine prodhuese për Loti 1 – Ndërmarrjet mikro dhe të vogla ku vlera e makinës prodhuese edhe diku 1,600 Euro me pjese përcjellëse.
- *Shih pikën 1.4 të udhëzuesit për aplikantë PZHRB 2020.*
31. Të drejtohem me kërkesë për sqarim të përkatësisë së biznesit tim.

Ndërmarrja prodhuese private tregtare ROLOPLAST nga Mitrovica është e regjistruar në vitin 2000. Sidoqoftë, në përgjigje të ThPP të PZHRB 2020 - Skema e Granteve „Programi i Zhvillimit Rajonal të Balancuar“ ndër kriteret është edhe qarkullimi vjetor për vitin 2019, vit gjatë të cilit nuk kam punuar e jam transferuar në kompleksin industrial në Trepçë por, gjatë vitit 2020 deri më 15.03.2020 kam qarkulluar 4.000 €.

Andaj të drejtohem me pyetjen sqaruese të përkatësisë së biznesit tim:

Lotin 1 (Loti 1 – Ndërmarrjet mikro dhe të vogla- Nga 2,000€ deri në 5,000 €) apo Lotin 2 Loti 2 – Ndërmarrjet mikro dhe të vogla- nga 5,001 € deri në 15,000 €.

Në cilin grup është I mundur aplikimi për këtë ThPP?

- *Klasifikimi për LOT-in përkatës duhet bazuar në qarkullimin për vitin e fundit fiskal 2019, Shih pikën 1.4 të udhëzuesit për aplikantë PZHRB 2020.*

32. Jam XX XX dhe po ju shkruaj në lidhje me Skemën e Granteve “Programi i Zhvillimit Rajonal të Balansuar” PZHRB 2020. Konkretisht lidhur me Loti 1 – Ndërmarrjet mikro dhe të vogla. Kam një ndërmarrje mikro, që aktivitetin primar e ka “4721 - Tregtia me pakicë e frutave dhe perimeve në dyqane të specializuara”. Qëllimi i projektit për të cilin dua të aplikoj lidhet ngushtë me veprimet e Skemës, konkretisht me rritjen e punësimit (në mënyre indirekte punësoj fermerë lokal), optimizimin e ciklit të jetës së produkteve (zgjas CJP që kam nga fermerët) dhe diversifikoj produktet/shërbimet në veprimtarinë time. Dua të aplikoj për blerje të një pajisje që zgjate ciklin e jetës së produkteve (frigorifer për produkte që dëmtohen shpejte për shkak se kërkojnë temperature të caktuar).

Pyetja që kërkoj përgjigje nga ju është kështu:

Edhe pse jam biznes me veprimtari tregtare, duke pasur parasysh se pajisja për të cilën dua të aplikoj nuk lidhet drejtpërdrejte me aktivitet tregtar, a kam të drejte të aplikoj për këtë lloj veprimi, pra për pajisje që nuk lidhet me aktivitet tregtar?

- *Shih pikën 2.4 të udhëzuesit për aplikantë PZHRB 2020.*

33. Përshëndetje i nderuar,

Ju lutem, nëse keni mundësi të bëni një sqarim me të detajuar të bizneseve që kanë mundësi të aplikojnë.

- *Shih “UDHËZUESI PËR APLIKANTËT E GRANTEVE MZHR/2020” - Skema e Granteve „Programi i Zhvillimit Rajonal të Balansuar” PZHRB 2020 (Lot I, Lot II dhe Lot III).*

34. Jam duke përgatitur aplikim për Thirrjen për Propozime 2020. Por i kam disa pyetje:

a. Makinerie që blihet, a ka kusht vendin e origjinës?

- *Jo nuk është e përcaktuar vendi i origjinës;*

b. Makinerie që blihet, a duhet të jetë e re?

- *Po, pajisjet/makineritë duhen të jenë të reja;*

c. Unë merrem me prodhim të akullit, dhe shitjen e tij në kafiteri. E pashe që investimet në automjete janë të papranueshme. Nëse do të doja që pickup-in tim ekzistues ta shndërroj në friz mobil (pra pjesën mbrapa të ja izoloj dhe të bëj si friz), a është harxhim i pranueshëm?

- *Kostot e pakualifikuara nuk duhet të jenë pjesë e projektit (Shih pikën 2.7 të udhëzuesit për aplikantë PZHRB 2020).*

35. Tek udhëzuesi për aplikant në piken 2.2 thotë si vijon me poshtë:
2.2 Aplikantët që nuk kualifikohen
Aplikantë potencialë nuk mund të marrin pjesë në Thirrje për propozime apo të përfitojnë grante nëse gjenden në ndonjërin prej situatave që renditen si më poshtë: Kanë bankrotuar apo janë në mbyllje, janë nën administrim të gjykatave, kanë hyrë në marrëveshje me kreditorë, ...
Pyetja ime është për startup, nëse një person ka kredi personale, a mund të aplikoj për start-up apo jo ?
- *PO, por duke u bazuar në kushtet e vendosura në piken 2.2 të udhëzuesit për aplikantë PZHRB 2020.*
36. Shpresoj që mund të më ndihmohet në lidhje me aplikimin për grant PZHRB 2020 (start-up) posaçërisht në pjesën që kërkohet dokumentacion i ofertës për makinerinë apo pajisjet/shërbimet e planifikuara (shih attachmentet). Unë jam duke aplikuar për një krijimin e një platforme edukative për të cilën më nevojiten kompjuterë (me pajisje përcjellëse), tavolina dhe karriga dhe një softuerë i specializuar për këtë punë e të cilin do ta blejë online. A duhet që paraprakisht të kam oferte për të gjitha këto që të aplikoj apo mos kjo duhet më vonë pasi të fitoj grantin ?
- *Oferta duhet të jetë pjesë e pakos së aplikimit, (Shih pikën 3.1 të udhëzuesit për aplikantë PZHRB 2020).*
37. Jam XXX XXX, përfaqësues i kompanisë përpunuese/prodhuese të pemëve dhe perimeve XXX XXX më vendndodhje në Gjilan.
Dëshat të pyes për sektorët e kualifikuar për aplikim:
Ndërmarrjet që operojnë në prodhimin dhe përpunimin e produkteve;
Nuk kualifikohet Bujqësia (çdo pajisje apo aktivitet që ndërlidhet me fushë veprimtarinë e bujqësisë që financohet nga MBPZHR përjashtimisht pajisjet/makineritë për prodhimin dhe përpunimin e produkteve).
Pasi që ndërmarrjet përpunuese/prodhuese janë ato të cilat e ulin importin dhe rrisin eksportin...
A kemi të drejte ne si Kompani për Aplikimin në këtë Grant pasi që merremi me përpunimin e pemëve dhe perimeve?
- *Shih pikën 2.4 të udhëzuesit për aplikantë PZHRB 2020.*
38. Desha të ju pyes nëse kam të drejt të marr pjesë në Lot I si person fizik pasi figuroj bashkëpronare në një biznes që figuron ende në arbk mirëpo është pasiv me shume së 4 vite?
Po ashtu, në UDHËZUESI PËR APLIKANTËT E GRANTEVE thuhet që në Lot I mund të marrin pjesë edhe bizneset edhe personat fizik. Ju lutem më udhëzoni se si të marr pjesë nëse më lejohet (duke pasur parasysh pyetjen më lart)? Unë dua të hap biznes të ri me emër të ri, pra start-up.
- *Nëse figuroni si bashkëpronare në një biznes nuk mund të aplikoni si person fizik (start up) por vetë si person juridik (biznes ekzistues).*
39. Uroj që të jeni mirë me shëndet dhe punët po ju ecin mire. Unë kam lexuar udhëzuesin e juaj për skemën e granteve, por prapë kam një pyetje në mënyrë që të jem me i saktë. Biznesi i takon kategorisë Lot 3 dhe punë primare e ka Gastronomin, bëhet fjalë për një nga bizneset më të mëdha në Kosovë, për sa i përket kësaj natyre.
A i lejohet këtij lloj biznesi që të aplikoj në këtë skemë të granteve në energji të ripërtitshme, pra me panele solare-diellore ?
- *JO, (shih pikën 2.4 të udhëzuesit për aplikantë PZHRB 2020).*

40. Çështja e TVSH-se, të thirrja e bizneseve, nuk është sqaruar në Udhëzues. A vlen e njëjta si vitin e kaluar (Nuk pranohet vetëm tek deklaruesit e TVSH-se) dhe a pranohet psh. oferta me vlerë 59,000 EUR për Lot 3, ku 9,000 EUR është TVSH-ja dhe 50,000 EUR mbetet si vlerë totale e projektit (30,000 EU grant dhe 20,000 EUR kontribut).
- *Ofertat që merren brenda vendit përmbajnë edhe TVSH në rastet e blerjeve brenda vendit është shpenzim i kualifikuar, kurse ofertat që merren nga jashtë Kosovës janë pa TVSH dhe në këto raste pagesa e doganës dhe TVSH-së nuk është shpenzim i kualifikuar. Aplikantët duhet të dorëzojnë ofertat për vlerën totale të projektit.*
41. Desha të pyes si mund të kyçem në SMAED, regjistrimin e kam bërë a duhet të presim ndonjë konfirmim apo diçka tjetër ?
- *Pas pranimit të konfirmimit për qasje në email, mund të kyçeni në SMAED (<https://smaed-online.rks-gov.net/>) ky proces kryhet brenda ditës.*
42. Po ju shkruajmë në lidhje me grantin për subvencione për biznese PZHRB Lot 3. Granti jonë do të fokusohet në degën e laboratorit Eramet i cili merret me kalibrimin e instrumenteve matëse dhe është i vetmi laborator i tillë i akredituar në Kosovë. Veprimtaria jone lejohet vetëm nëse jemi të akredituar nga një trupe akredituese. Përderisa DAK (Drejtoria e Akreditimit të Kosovës) nuk është ende kompetente për akreditimin e laboratorëve kalibruese ne duhet të kërkojmë akreditimin nga Institute jashtë vendit. Procesi i akreditimit përfshinë rivlerësimin në baza vjetore që përfshinë një kosto relativisht të larte.
- Pyetjet tona janë:
1. Në cilën kategori të Shtojces_B1_buxheti-PZHRB2020 mund të futet shpenzimi i tillë për akreditim?
 2. Laboratori ynë Eramet është njësi/degë e veçante në kompaninë ERAMED që ka për aktivitet kryesor kodin: 7120 Testimi teknik dhe analizat. A është në rregull nëse aplikimin e bëjmë në kuadër të njësisë së laboratorit Eramet?
- *Shpenzimet e tilla hynë në kosto të pakualifikuara dhe nuk duhet të jenë pjesë e projektit. (Shih pikën 2.7 të udhëzuesit për aplikantë PZHRB 2020).*
43. A mund të aplikoj për pajisje për përpunimin e frutave (për të prodhuar lëngje, marmelada ...). A është e mundur apo nuk është e pranueshme?
- *PO është e lejueshme, (shih pikën 2.4 të udhëzuesit për aplikantë PZHRB 2020).*
44. Nëse keni mundësi të na jepni sqarime shtese lidhur me - Skema e Granteve „Programi i Zhvillimit Rajonal të Balansuar“ PZHRB 2020 (Lot I, Lot II dhe Lot III), konkretisht lidhur me Lot III. Kam tri pyetje si me poshtë:
- a. Tek udhëzuesi ceket që qarkullimin në ATK duhet të dëshmohet me Vërtetim të ATK-se, a është fjala këtu për dëshmi të qarkullimit që mundet më qenë deklaratat e TVSH-se ose gjendja e përgjithshme e tatimpaguese , apo kërkohet vërtetim i veçante i lëshuar nga ATK që vërteton qarkullimin.

- *Qarkullimi duhet të paraqitet në aplikacionin për aplikim ashtu si vlerë e nxjerrë nga Vërtetimi i lëshuar nga ATK i cili dëshmon qarkullimi për vitin e fundit fiskal, apo nga deklaratimet e bëra për vitin e fundit fiskal.*
45. Makineria e re e nevojshme për veprimtarinë time është e shtrenjte. Mirëpo unë kam oferte të volitshme për makineri te përdorur ne treg me karakteristika të njëjta. Deshta të pyes se a lejohet blerja e pajisjeve të përdorura apo jo.
- *Pajisjet e përfshira në projekt duhet të jenë të reja shih pikën 2.7. të udhëzuesit për aplikantë PZHRB 2020.*
 - a. Përveç aplikacionit qe plotësohet në mënyre elektronike, a luan rol në vlerësim të aplikacionit nëse bashkëngjisë edhe një plan profesional të biznesit të përgatitur nga një konsulent i kualifikuar.
 - *Shih mënyrën e aplikimit pika 3.1 të udhëzuesit për aplikantë PZHRB 2020, vetëm aplikacioni dhe shtojca e përcaktuar me udhëzimin për aplikantë PZHRB 2020 duhet të përcjellën.*
46. Disa pyetje në lidhje me propozimet e Skema e Granteve „Programi i Zhvillimit Rajonal të Balancuar“ PZHRB 2020.
- Pyetja 1. Për çështjen e TVSH-se, nëse oferta e pajisjeve është me vlere te TVSH-se, dhe nëse kërkuesi I grantit është me TVSH (ka certifikatë të TVSH), në Excelin e Buxhetit dhe ne Burimet e Pritura te Financimit a duhet të shënohet vlere e ofertës me TVSH apo pa TVSH?. Ju lutem na sqaroni çështjen e TVSH.
- *Shih përgjegjjen Nr.40.*

Pyetja 2. A duhet të dorëzohet në aplikacion një oferte apo me shume oferta për pajisjet e njëjta për të cilat synohet të bëhet investimi?
 - *Një ofertë dorëzohet për pajisjet e njëjta të përfshira në projekt.*
47. U shkruajmë nga Fondacioni Kosovar për Ndërmarrësi Sociale. Jemi organizatë që promovojmë ndërmarrësin sociale si koncept i ri i biznesit social për të rinj, gra dhe grupe të cenueshme. Arsyja pse ju shkruajmë, qëndron se në takimin e fundit me anëtarë të organizatës sonë, disa të rinj dhe gra kanë pyetur në lidhje me kriteret e aplikimit sa i përket Skemës se Granteve „Programi i Zhvillimit Rajonal të Balancuar“ PZHRB 2020, specifikisht për Loti1.2 Start-Up. Pyetja e përmbledhur është si vijon: A janë të kualifikuar për të aplikuar për Lotin 1.2 strat-up, personat fizik (t ‘rinj, gra, dhe persona nga grupet e cenueshme) por që nuk kanë të regjistruar ende formalisht ndërmarrje ose ndonjë formë të biznesit ?
- *Loti 1 – Start-up përfshinë të gjithë personat fizik te cilët nuk kanë ende biznes të regjistruar.*
48. Kam disa pyetje rreth grand projektit për biznese te vogla qe nuk e kam te qarte:
A duhemi ne te shkruaj projekt propozimin bazuar ne këto pika:
- a. Kapaciteti financiar
 - b. Relevanca e veprimit
 3. Efektshmëria dhe arritshmeia
 - d. Qëndrueshmëria e veprimit
 - e. Buxheti dhe efektshmëria në kostot
- A duhen të gjitha këto pika të jenë ndaras njëra prej tjetrit, apo gjitha me një PDF?

- *Pikat e listuara me lartë nga 1-5 duhet të përfshihet si përgjigje në formularin për aplikim e jo të bashkëngjiten si dokumente të veçanta, (shih mënyrën e aplikimit pika 3.1 të udhëzuesit për aplikantë PZHRB 2020).*
 - b. Te rubrika start up, a mund te aplikojnë edhe biznese qe janë regjistrua, por qe ende nuk kane filluar te operojnë? Sepse fusnota ishte vetëm biznese qe pretendojnë te hapen.
 - *Bizneset te cilat nuk kanë filluar ende të operojnë dhe kanë qarkullimi (minimumi 0.00 € deri në 5,000.00 € të dëshmuara nga ATK) hynë në kategorinë LOT 1 (biznes ekzistuese).*
49. Kam dy pyetje :
- a. A bën më qenë oferta e pajisjeve nga një shtet tjetër i huaj.
 - *Po oferta mund të jetë nga një shtet tjetër i huaj.*
 - b. Biznesi ne me veprimtari është më shitje të mobileve tani dëshiron me hi ne prodhimin e tyre a ka drejt me apliku.
 - *Shih pikën 2.4 të udhëzuesit për aplikantë PZHRB 2020.*
50. Në lidhje me: Skema e Granteve „Programi i Zhvillimit Rajonal të Balancuar“ PZHRB 2020 (Lot III). Ju lutemi nëse ka mundësi të na sqaroni me konkretisht si të veprohet në tabelën pika 4. PLANI I VEPRIMIT, sepse nuk e kemi të qartë, ju lutemi qe të na jepni ndonjë shembull se si të veprojmë.
- *Plani i veprimit duhet të përmbaje aktivitetet qe do të realizohen në muajt e caktuar se si i bëni planifikimin e realizimit, po ashtu duhet shënuar organi implementues ne kolonën e fundit të planit të veprimit*
51. Lidhur me grantin e ofruar nga Ministria e Zhvillimit Rajonal, nëse ka mundësi të na sqaroni se a mund të kërkohet granti për zhvillim të softuerit, e që do të nënkuptonte mbështetjen nga granti për të angazhuar/punësuar fillimisht disa persona që të zhvillojnë një version te softuerit. Vet softueri i zhvilluar pastaj do të krijonte vende të reja të punës për ta avancuar dhe plasuar softuerin.
- *JO*
52. Jam XXX XXX prej Suharekës, i kam disa pyetje për aplikim për grant (start up), Nëse kam kredi aktive a mundem me apliku ?, Nese jam i punësuar a mundem me apliku ?
- *PO shiqo udhëzuesin për aplikantë PZHRB 2020 pikën 1.4. dhe 1.5.*
53. Desha të sqarohem rreth Grandit nga MRZHJ- dhe kam disa pyetje.
- a. Leternjoftimin e kam te skaduar dhe me patent shofer a mund ta hapi llogarine ne SAMED?
 - *Për qasjet në SMAED shih udhëzuesin për aplikantë PZHRB 2020 është personi kontaktues dhe mbrënda ditës rregullohen qasjet për SMAED.*
 - b. Planin e buxhetit b1-buxheti, a duhet të shkruhen shpenzimet e marketingut (për brendimin e lokalit me reklama)? dhe deri sa është e lejueshme për grandt start up? si dhe a duhen të printohen dhe të skanohen, apo direkt të konvertohen në PDF dhe të uploadohen.? Po ashtu a duhet edhe ofertat (profaturat) të bashkëngjiten për këto shpenzime?
 - *Nëse planifikohen shpenzime të marketingut mund të paraqiten deri në 5% të vlerës totale të projektit, dhe për të njëjtat duhet të sigurohet oferta dhe të bashkëngjitet shih pikën 2.6. të*

udhëzuesit për aplikantë PZHRB 2020. Buxheti duhet të jetë i formatit excel dhe duhet të bashkangjitet.

c. Në deklaratën e klientit tek fusha: POZITA çka duhet të shkruhet për aplikantet start up (sipermarres, aplikanti)?

- *Mund të shënohet Aplikanti.*

d. Për ofertat (profaturat) a duhet te jene së paku 3 ofertues të ndryshëm apo mundem më shtu vetëm një ofertues (profatur), si dhe a duhet të përmbaj emër e aplikusit profatura?

- *Një ofertë dorëzohet për pajisjet e njëjta të përfshira në projekt, dhe oferta duhet ti përmbajë shënimet e ofertuesit dhe të pranuesit të ofertës.*

5. Inventari a perlogaritet si kosto per start up apo mund te vendosen ne shpenzime ne nenkategori dhe a duhet te kete ofert (profature) patjeter?

- *Për çdo blerje/furnizim/shërbim në kuadër të projektit duhet të ketë ofertë por paraprisht shiqoni udhëzuesin për aplikantë pikën 2.6. dhe 2.7.*

54. Jemi duke aplikuar ne thirrjen për grante dhe oferta për pajisjen tonë te planifikuar për blerje është 31,800.00 euro, qe i bie mbi vlerën e shpenzimeve të kualifikueshme me thirrjen, per 1,800 €, pyetja jon është;

a. A është e pranueshme kjo ofertë qe është mbi vleren 30,000.00 €, ku shum e pa kualifikueshem (1800)te cilen do ta mbulojm ne me mjete tona vetanake

b. Ne shtojcen e buxhetit , kontributi i aplikantit duhet te jet 3,000 €, apo edhe shuma tjeter qe eshte e pa kualifikueshem ne total 4,800 €

- *Shih përgjegjjen Nr.12.*

55. Jam XXX XXX, jam nga Podujeva dua me be nje pyetje ne lidhe me aplikacionin per grant. Une e kam biznesin te regjistruar me daten 17/12/2018 por nuk kam as nje qarkullim me biznes, arsya pse e kam te regjistruar dhe nuk kame qarkullim eshte se pa pasur ndonje perkrahje nga ndonje institucion nuk kam mudur te filloj, biznesi im eshte i regjistruar per metal punus.

Pyetja qe du te beje eshte: Ne cili Lot ben te aplikoj, edhe Qertifikata e biznesit qe thuhet qe duhet te jete e re a duhet te shkoj prap ne komun te nxjerr tjeter qertifikate kete nuk e kam te kjarte.

- *Shih udhëzuesin për aplikantë PZHRB 2020 pikën 1.4. dhe 1.5*

56. Kam disa pyetje rreth aplikimit, ndër to janë:

a. A lejohet të aplikojnë bizneset që kanë prodhimin e artikujve të tjerë të betonit, llaçit dhe çimentos (aktivitet primar)- kodi NACE 2369;

- *Shih udhëzuesin për aplikantë PZHRB 2020 pikën 2.4.*

b. A lejohet të aplikojnë therrtoret (përpunimi i mishit) për pajisje?

- *Shih udhëzuesin për aplikantë PZHRB 2020 pikën 2.4.*

c. Për bizneset që janë të hapura më herët por që nuk kanë pasur qarkullime vjetore LOT 1 kërkohet edhe lista e pagave të punëtorëve sipas ATK, a janë të lejuara të aplikojnë dhe cilat janë hapat që duhet ndërmarrë më tutje (A duhet të dërgoj listën e pagave pa asnjë punëtor të deklaruar)?

- *PO janë të lejuar dhe duhet të bashkangjisin listën e e punëtorëve.*

57. Une e kam themeluar nje biznes ne Nentor, 2019 (27/11/2019), si Sh.P.K. me adrese ne Prishtine. Ne kete startup une jam pronar/aksionar, 100%.

Deri kete muaj qarkullimi shkon pak ma shume se 5,000 euro, kurse ne dhjetor, 2019 kam pas te hyra rreth 670 euro. Ju lutem me tregoni per cilin LOT mund te aplikoj? A i plotesoj kushtet per aplikim deri ne shumen 15,000 euro?

- *Shih udhëzuesin për aplikantë PZHRB 2020 pikën 1.4. dhe 1.5.*

58. Lloji i biznesit SHPK me 3 aksionar, veprojme dhe e themeluar ne Kosove me 2 turq dhe nje kosovar. A kemi te drejt aplikimi?

- *Aplikanti duhet të jetë shetas Kosovar.*

59. Bazuar ne Udhezuesin per aplikantet e granteve MZHR/2020, Skema e Granteve "Program i Zhvillimit Rajonal te Balancuar" PZHBR 2020, perkatesisht LOT 3, perkatesisht Piken 2.6 te ketij Udhezuesi, nder tjerash sqarohet se, hape citatin: "Numri i aplikimeve dhe granteve për aplikant. Një aplikant nuk mund të dorëzojë më shumë se një aplikacion në këtë Thirrje për Propozime." Mbyllë citatin.

Ju lutemi mundesisht të na sqaroni se me "një aplikant" a nenkuptohet personi fizik i cili mund te jete pronar apo aksionar i dy apo me shume kompanive/bizneseve apo nenkuptohet subjekti juridik (biznesi) konkret pavaresisht se kush eshte pronar apo aksionar, ndonese pronari apo aksionari mund te jete pronar apo aksionar edhe ne disa kompani te tjera?

- *Në rastet kur një pronar është aksionar në 2 apo më shumë biznese ka drejtë aplikojë vetëm njëher me njërin prej bizneseve, dhe në të njejtën kohë e shpenzon mundësinë e aplikimit të bizneseve tjera që i ka në pronësi.*

60. Kam 2 pyetje në lidhje me aplikimin.

a. Kam një biznes me mbi 31.000€ qarkullim gjatë vitit 2019 dhe 5 punëtor aktiv, a më lejohet të aplikoj në LOT III?

- *PO.*

b. Projekti im nëse kualifikohet në LOT III do të jetë i kushtueshëm 42.000 € që do të ndahet: 12.000€, nga unë si bashkëfinancues (28.57%) dhe 30.000€ nga MZHR (71.42%) - A KAM TË DREJTË NË KETË BASHKËFINANCIM.

- *Shih përgjegjjen NR. 12.*

61. Përsh desha të ju pyes në lidhje me dy çështje për aplikim në kuader të LOT 3 (biznes ekzistues):

a. A pranohet blerja e pajisjes për bartje të prodhimeve të kompanisë, lloji piruner (vilushker) ?

- *JO.*

b. A përkrahen dhe a kanë të drejtë aplikimi bizneset hotelerie?

- *Shih udhëzuesin për aplikantë PZHRB 2020 pikën 2.4.*

62. E kemi të pa qartë për vendosjen e referencës, rast konkret në dëshirojmë të aplikojmë me LOT1 shtojca A@ biznes ekzistues .

- *Lot 1 biznese ekzistuese i dedikohet bizneseve që kanë qarkullim nga 0-5,000.00 € në vitin e fundit fiskal të deklaruar në ATK.*

63. Po u shkruaj me qëllim që të marrë sqarime dhe udhëzime rreth aplikimit për grante për shkak se po hasi në shumë problematika gjatë procesit të aplikimit. Po mendoj që të aplikoj si startup, a duhet që të bashkangjitet edhe plan biznesi për shkak se e pashë tek platforma e aplikimit online

që kërkohej vetëm pjesa financiare me pajisje. Përpos këtyre që i përmenda më lartë, në pergjithësi po kemi vështërsi rreth aplikimit.

- *Shih udhëzuesin për aplikantë PZHRB 2020 pika 3.1.*

64. Po ju shkruaj duke i'u referuar shpalljes së ftesës për mbështetje të bizneseve me donacione nga ana e Ministrisë suaj!

Deshta të dije nëse ka mundësi se ku duhet të drejtohem, në cilin e-mail apo numër telefoni sepse asnjë burim zyrtar nuk është prezentuar në webfaqe përveq e-mailit tuaj për të komunikuar me zyrtarët për sqarime teknike

- *Të gjitha sqarimet për thirrjen për propozime PZHRB 2020 bëhen përmes e-mail siç është e përcaktuar në udhëzuesin për aplikantë pika 3.4. e-maili kontaktues.*

65. Jemi duke e përgaditur dukumentacionin për aplikim për grant. Deshta të ju pysë në lidhje me ofertën për makineri apo pajisjet të cilën duhet ne për t'a paraqitur.

Çka nëse ne nuk mundemi me siguru ato pajisje, pajisjet duhet të importohen dhe eksportohen dhe në rast se neve nuk na dërgohet një profaturë, mirëpo në atë rast ne mund të sigurojm një listë të çmimeve të vulosur dhe nënshkruar nga ana jonë. Oferta duhet të sigurohet nga ofertuesi?

- *Oferta është obligative të dorëzohet për pajisjet/shërbimet e përfshira në projekt, dhe oferta duhet t'i përmbajë shënimet e ofertuesit dhe të pranuesit të ofertës.*

66. Unë XXX dëshiroj të aplikoj për një grant që MZHR-ja po ndan grante për ata që duan të hapin biznese, deshta me ju pyet a ka ndonjë bonus pa bashkëfinancim sepse i kam prindërit pa punë dhe vet jam pa punë, e për atë arsye nuk mundem me bashkëfinoncu. Kërkoj nga MZHR-ja që të më ndihmojë që t'a hap biznesin.

- *Bashkëfinancimi është obligativ siç është përcaktuar me udhëzuesin për aplikantë PZHRB 2020 pika 1.5.*

67. Në lidhje me grantin e shpallur nga Ministria e Zhvillimit Rajonal.

A kualifikohen restaurantet/picerit, furrat dhe sallonet e bukurisë, që të gjitha këto me qëllim që të rriten kapacitetet dhe të shtohet numri i të punësuarve në biznes?

A kualifikohen kompanit e vogla ndërtimore me 3 deri në 9 punëtorë, që përmes aplikimit ata të pajisen me vegla për punë?

P.sh. për blerjen e mikserave, frigoriferave, makineri të ndryshme etj.

- *Shih udhëzuesin për aplikantë PZHRB 2020 pika 2.4.*

68. Nëse subjekti është në Lot 1 dhe dëshiron të blejë makineri në vlerë 6000€ duke planifikuar që nga Ministria të mbulohet 5000€, kurse pjesën tjetër t'a mbulojë pala përfituese. Shuma e grantit a është deri në 5000€ nga Ministria apo 5000€ janë së bashku me financimin e përfituesit?

- *Shih përgjegjjen Nr.12.*

69. Jam i interesuar të aplikoj për grantin që ofron Ministria e Zhvillimit Rajonal për Start-up biznese. Deshta të ju pyes se si duhet të pergatitet oferta për pajisje në rastin kur ato blihen jashtë vendit.

- *Oferta është obligative të dorëzohet për pajisjet/shërbimet e përfshira në projekt, dhe oferta duhet t'i përmbajë shënimet e ofertuesit dhe të pranuesit të ofertës.*

70. Po ju shkruaj për sqarime më specifike rreth kësaj pike në Udhëzues Granti: "Programi i Zhvillimit Rajonal të Balansuar" PZHRB 2020 (Lot I, Lot II dhe Lot III) Pika 2.4. -Tregtia (me pakicë e shumicë), ndërtimtaria, bujqësia (çdo pajisje apo aktivitet që ndërlidhet me fushëveprimtarinë e bujqësisë që financohet nga MBPZHR përjashtimisht pajisjet/makineritë për prodhimin dhe përpunimin e produkteve) dhe shëndetësia janë sektorë që NUK KUALIFIKOHEN.
- Ju lutem më tregoni se a kualifikohen:
Pajisjet për përpunim të qumështit të dhisë
Pajisjet për paketim çajrave
Kazanat për zierjen e uthullës dhe mbushjen e bidonave.
- PO.
71. Po ju shkruaj për të bërë disa pyetje pasi që po synojë të aplikoj për grantet e PZHRB 2020 në emër të Nënës sime, që është Oftalmologe e Specializuar në Gjakovë. Pyetjet po i rënditi më poshtë:
Në vitin e kaluar kam aplikuar në SMAED, dhe numri i protokollit të aplikimit është "0010-2019-381" por kurrë nuk kemi marrur përgjigje për rezultatet që nga Marsi i vitit 2019 kur kam aplikuar. A ka mundësi të më njoftoni në lidhje me këtë vendim apo se çfare ka ndodhur? Edhe pse firma e Nënës është e hapur më shumë se dy vite, dhe qarkullimi vjetor është me i madh se 15,000 euro, a ka mundësi me apliku për një grant me vlerë vetëm 9,000€? (jo 15,001-30,000€)?
Arsyeja është sepse që 15 vite që nëna punon, edhe pse i paguan të gjitha tatimet dhe çdo obligim tjetër, përveç se punëson gra dhe trajton qindra pacientë pa pagesë, kurrë nuk i është dhuruar asnjë grant, përderisa qindra biznese në Kosovë marrin më shumë grante se sa që bëjnë biznes. Nëse egziston mundësia për të aplikuar për grant për aq sa është nevoja, pra vetëm për 9,000€ (e jo doemos të rrisim kërkesën që t'i kalojmë 15,000€ pa marr parasysh nevojat reale) të lutem na njoftoni nëse kualifikohen profesionistët e ndershem dhe familjaret e dëshmoreve të kombit me gjenerata të tëra.
- Nëse biznesi juaj është në fushën e shëndetësisë shih udhëzuesin për aplikantë pika 2.4. sepse shëndetësia nuk kualifikohet si sektorë. Sa i përket njoftimi përmes SMAED sistemi ju njofton kur aplikacioni është dorëzuar tek ne kurse rezultatet e aplikimit të gjitha publikohen ne webfaqen e MZHR-së.
72. Jam XXX XXX punonjës i RTK-së, kam një përvojë të gjatë në projektpropozime dhe menagjimin e tyre. Duke filluar nga IPA, EBRD dhe USAID etj.
Pyetja lidhet me kërkesën për Ofertë? Si të aplikohet dhe procedurat që duhen ndjekur
- 3.1 Mënyra e aplikimit
....Pako e Aplikimit, në bazë të natyrës së biznesit të Aplikantit:
- i) Pako aplikimi për LOT 1 si dhe dokumentet që duhet të dorëzohen (për startup)....
Dokumentet tjera shtesë:
PYETJA LIDHET ME KËTË KËRKESË:
Oferta për makinerit apo pajisjet/shërbimet e planifikuara në projekt për vlerën totale të projektit (oferta duhet të përmbaj të dhënat e sakta të ofertuesit dhe nuk duhet të jetë më e vjetër se data e shpalljes së thirrjes për propozime).
Pyetja është: Si mund të pergaditet një projekt konkretisht të mirret oferta për projekt para se të shpallet thirrja për propozime?
a. A është fjala për pajisjet dhe çmimoret e para asaj date.

- *Oferta duhet të jetë nga data e shpalljes së thirrjes jo para shpalljes së thirrjes për propozime.*
b. Apo është thjesht një llapsus i cili nëse nuk është i tillë bije ndesh me ligjet e prokurimit dhe konkurentshmërise.

- *Grantet e kësaj natyre nuk aplikojnë ligjin e prokurimit por udhëzimin administrativ përkatës.*
c. A duhet të jetë e regjistruare kompania për Lot 1 para shpalljes së Konkursit.
- *Për Lot 1 janë dy opsion si Start-up ose si biznes i regjistruar.*
d. A duhet të regjistrohet kompania pas përfitimit?
- Nëse përzgjidhem si përfitues dhe keni aplikuar për Lot 1 start-up duhet të regjistroheni si biznes.

73. Ju shkruajmë për disa sqarime rreth Thirrjes për skemën e granteve „Programi i Zhvillimit Rajonal të Balansuar“ PZHRB 2020. Ne kemi disa pyetje dhe nënpyetje, të cilave shpresojmë se do t'i na përgjigjeni, meqë na duhet informacion për t'i kompletuar dhe për të pasur më të qarta kërkesat e thirrjes.

- a. Personat që kanë biznes ekzistues, a kanë të drejtë të aplikojnë për grant për startup për një biznes/ide krejt tjetër?
- *JO.*
 - b. Rreth financimit të granteve kemi pak paqartësi, p.sh. shuma 30,000.00 €, a e përfshin komplet vlerën e projektit, apo vlerën e grantit që ofroni ju (pa pjesën e bashkëfinancuar)?
 - *Shih përgjegjjen Nr.12.*
c. Ndër fushat që përjashtohen, është edhe ndërtimtaria. Duam të dimë, a përjashtohet vetëm ndërtimtaria si shërbim, apo edhe produktet? D.m.th, a lejohet prodhimi i produkteve ndërtimore?
 - *Prodhimi i produkteve është i kualifikuar.*

74. Ju lutem, një sqarim nëse keni mundësi?!

Çfarë kërkohet **më konkretisht** në pjesën e aplikacionit lidhur me aktivitetet? Si të plotësohen ato fusha nëse mundeni të e konkretizoni me shembull?

- *Tek aktivitetet paraqitet secili aktivitet për muaj prej fillimit të projektit deri në përfundim.*

75. Sa është numri i ofertave që duhet ti marrim për një llojë të paisjeve ?

A lejohet blerja e paisjeve në tregun jashtë Kosovës nëse pajisjet vijnë me faturë të rregullt ?

- *PO.*

76. Doja të ju bejë një pyetje në lidhje me skemen e granteve të cilat i ka publikuar MZHR-ja.

Duke u bazuar në udhëzuesin e skemes së granteve të publikuar nga MZHR-ja në pikën 1.3. Synimet e Thirrjes për Propozime dhe duke u mbështetur tek Synimet Specifike të thirrjes pika i. Zvogëlimi i papunësisë përmes krijimit të vendeve të reja të punës, me theks të veçantë për të rinjtë; dhe pika ii. Përkrahja e zhvillimit të bizneseve të reja dhe atyre me potencial rritjeje
Pyetja ime është a mund të aplikoj për pajisje mjekësore për klinikë veterinare?

- *JO, Shih udhëzuesin për aplikantë PZHRB 2020 pika 2.4.*

77. Duke u bazuar në udhëzimin për grante nga MZHR-ja, në veçanti, pika 1.3 (Synimet e thirrjes për propozime) dhe Synimet specifike (pika i. Zvogëlimi i papunësisë përmes krijimit të vendeve të reja të punës, me theks të veçantë për të rinjtë; dhe

ii. Përkrahja e zhvillimit të bizneseve të reja dhe atyre me potencial rritjeje), ideja për projektin tim përputhet, mirëpo më poshtë në pikën 2.4 (Sektorët apo temat), në një paragraf thuhet se "Tregtia (me pakicë e shumicë), ndërtimtaria, bujqësia (çdo pajisje apo aktivitet që ndërlidhet me fushvëprimtarinë e bujqësisë që financohet nga MBPZHR përjashtimisht pajisjet/makineritë për prodhimin dhe përpunimin e produkteve) dhe shëndetësia janë sektorë që NUK KUALIFIKOHEN". Andaj, jam në mëdyshje se a mund të aplikoj për paisje për përpunimin e mjaltit dhe produkteve të mjaltit, për shkak se kjo i perket fushës së bujqësisë.

- *PO (shih pikën 2.4 të udhëzuesit për aplikantë PZHRB 2020).*

78. Në vitin e kaluar me 01.02.2019 ne si qendër rinore publike e kemi hapur një Ndermarrje Sociale, ku të punësuar janë të rinjtë e Skenderajt. Kemi filluar si një Startup përkrahur nga UNDEF dhe Komuna e Skenderajt. Shuma që kemi pranuar nuk i ka plotësuar nevojat për investimet që kemi bërë në këtë ndërmarrje, si rrejdhoj e kësaj kemi nevojë edhe për disa paisje shtesë që ky startup që ka filluar në vitin e kaluar të kompletohet me pajisjet e nevojshme për punë.

Ne kemi hapur Ndermarrjen Sociale Pastiqeria "Snap Cake" në Skenderajt.

Për tu regjistruar si ndërmarrje sociale ende ligji për ndërmarrje sociale nuk është në fuqi etj. Ne aktualisht kemi statusin e OJQ-së. Pra kjo ndërmarrje aktualisht menaxhohet nga Qendra Rinore Publike e Skenderajt, ku janë 6 studentet e punësuar dhe dy familje që përgatitin ëmbëlsira për këtë pastiqeri. Pra është ndërmarrje sociale me bazë në komunitet

Sipas jush a mund të hym edhe ne në garën si biznes ekzistues, por me statusin e ojQ-së, qëllimi për të fuqizuar StratUp biznesin që tashmë ne kemi, Ndermarrjen Sociale Pastiqeria "Snap Cake" e cila ka mbi 100 meter katëror lokal me qira dhe stafin e vet që punon i ndarë nga Qendra Rinore, por ende jo me letra.

- *Kjo thirrje i dedikohet vetëm bizneseve dhe personave që dëshirojnë të fillojnë ndonjë biznes, jo organizatave që kanë statusin e OJQ-ve.*

79. Une jam e interesuar të aplikoj për Lot 1 (Biznes Ekzistues) mirepo kam disa pyetje/

Une kam perfituar mjete nga UNDP në tetor të vitit të kaluar dhe po në këtë kohë kam filluar të operoj si biznes, mirepo veprimtaria e biznesit tim është prodhim i veshjeve që i perkasin kryesisht sezonit të verës dhe përgjatë vitit të kaluar nuk kam operuar deri në fillim të këtij vitit.

Tash une si biznes i ri nuk kam se si të deklaroj pasqyra financiare të vitit 2019 si është kërkuar nga ju, si dhe jam biznes që ende nuk i ka përbushur një vit prej kur është themeluar biznesi.

A kam të drejtë të aplikoj apo jo?

Sepse kam nevojë për disa makineri për të përmirësuar produktivitetin e produkteve.

- *Ekziston mundësia për aplikim (shih pikën 1.4 të udhëzuesit për aplikantë PZHRB 2020).*

80. Ju shkruaj në lidhje me Skemen e Granteve „Programi i Zhvillimit Rajonal të Balansuar“ PZHRB 2020. Unë kam biznes ekzistues-Sallon Ondulimi dhe dua të aplikoj për zgjerim biznesi për Lot 1. Punoj me kapacitet të kufizuar mirëpo dua t'a zgjeroj biznesin në aspektin e karrigeve për klient, pasqyrave por edhe zgjerimin e shërbimeve tjera që me hëret nuk i kam pasur. Mirëpo ajo që dua të ju pyes është nëse kam të drejtë të aplikoj edhe për materiale hargjuese si ngjyra të flokëve, flokë për zgjatje, gella për rregullimin e thonjëve dhe materiale tjera shpenzuese për grim. Si dhe ofertat që marr nga furnitorët dhe i bashkangjes në aplikim a duhet të jetë ofertë nga një furnitor i vetëm apo kam mundësi për produkte të ndryshme të marr oferta të ndryshme.

- *Shih pikën 2.6 dhe 2.7 të udhëzuesit për aplikantë PZHRB 2020, për pajisjet/shërbimet të cilat nuk mund të përfshihen në një ofertë të vetme mund të bashkangjitet edhe oferta tjera për pajisjet/shërbimet tjera.*
81. Unë perfaqesoj XXX XXX SH.A - fabrika për ambalazhimin e ujit XXX.
- Ne kemi linjën e prodhimit e cila është jashtë funksionit dhe e cila na mundëson edhe prodhimin e lëngjeve të ndryshme dhe në këtë drejtim ka disa vite që po duam të shtojmë numrin e produkteve të ambalazuara në fabriken tonë e që aktualisht është 12 llojë të ujit të ambalazhuar.
- Ne këtë kontest kam dy pyetje si nevojë për qartësim para se të vendosim për aplikacionin për grant nga Ministria e Zhvillimit Rajonal.
- a. Nëse ne duam të fillojmë me prodhimin e ambalazhimit të dy produkteve të reja dhe në këtë rast ne duhen kallapet e aluminit për fryrjen e modelit të ri të shisheve, rrjedhimisht ne duhet të bëjmë edhe porosinë e tiketave specifike të produktit të ri me dizajn përkatës. A janë kosto të kualifikueshme, të domosdoshme për implementimin e projektit, kostoja e tiketave të cilat janë pjesë integrale e shisheve të produktit të ri apo për mbështetje në këto raste kualifikohen vetëm asetet fikse dhe kostoja e tyre doganore bashkë me transportin e tyre apo çka konkretisht kualifikohet në këtë rast?
- *Shih udhëzuesin për aplikantë PZHRB 2020 pika 2.6. dhe 2.7.*
- b. Tek aplikacioni, respektivisht Shtojca A4 pika nr 5 duhet të plotësohet Projektioni Financiare. A duhet kjo pjesë të plotësohet për të dhënat totale financiare të të gjithë fabrikës apo vetëm të produktit të ri për të cilin ne po aplikojmë t'a lancojmë në treg?
- *Për të dhënat totale të biznesit plotësohet projektioni financiar.*
82. Ju lutemi sqaroni më shumë detajet e kriterëve të vlerësimit të aplikacionit. Konkretisht, çfarë saktësisht mendonohet kur thuhet më poshtë:
1. Kapacitetet financiare dhe operacionale
 2. Rëndësia e procedurës
 3. Efikasiteti dhe arritshmëria
 4. Qëndrueshmëria e trajtimit
 5. Buxheti dhe efektiviteti i kostos
- *Pikat e listuara më lartë nga 1-6 duhet të përfshihen si përgjigje në formularin për aplikim për të cilat ka pyetje adekuate që ndërlidhen me këto kriterë të PZHRB 2020.*
83. A është aplikacioni i pranueshëm, i cili kërkon zhvillimin e një sistemi për pastrimin e ajrit nga salla e punës. Ai përbëhet nga disa elementë që duhet të paraqiten në vend dhe në përputhje me hapësirën e dhënë.
- *Shih pikën 2.6 dhe 2.7 të udhëzuesit për aplikantë PZHRB 2020.*
84. Po ju shkruaj në lidhje me disa pyetje për aplikim në thirrjen e propozimit për vitin 2020, nga MZHR, lot 2.
1. Tek spjegimi i aktiviteteve, organi implementues qka saktësisht nënkupton?
- *Organi implementues nënkupton se kush është realizues i aktiviteteve të cekura.*
2. A është ne rregull nese tek rubrikat e aktiviteve, ndonjë aktivitet të perfundoj brenda një muaji dhe të mos ndahet në 6 muaj?!
- *PO.*

85. Dua të ju pyes në lidhje me Skemen e Granteve „Programi i Zhvillimit Rajonal të Balansuar“ PZHRB 2020 per lot 1 3

Si kriter për aplikim keni kërkuar: Të jetë në gjendje të demonstrojë likuiditetin e kompanisë (apo likuiditetin potencial).

A keni mundësi të më ofroni informata se a duhet të dorezohet një dokument i tillë në fazën e parë të aplikimit me SAMED, nëse po ju lutem shumë me tregoni se ku duhet t'a marrë këtë dokument pasi që si biznes nuk kam pasur rast ta marr ndonjë dokument të tillë asnjëherë.

- *Kjo fazë është pasi të parakualifikoheni dhe ky dokument nuk nevojitet në këtë fazë të dëshmohet.*

86. Duke ju referuar thirrjes suaj për propozime PZHRB 2020, konkretisht LOT 3

Pyetja për Sqarim është:

1. Pika 1.5 Shuma e Granteve (lot 3) është nga 15,001 deri 30,000€ kërkesa për sqarim është që këto shuma paraqesin vlerën maksimale të grantit apo e projektit .

Pra nëse rastin tonë vlera e projektit është 45,000€, a mund ne të kërkojm 30,000€ (grant 66.67%) ndërsa bashkëfinancimi jonë të jetë 15,000€ (33.33%).

- *Shih përgjegjjen Nr.12.*

87. A ka të drejtë aplikimi nëse numri i punëtorve të regjistruar është 0 (zero), pasi që biznesi zhvillohet kryesisht në sezonin verorë, dhe punëtorët janë sezonal.

- *PO, Shih pikën 1.4 të udhëzuesit për aplikantë PZHRB 2020.*

88. Përshëndetje, ne si biznes "TORNO DEKOR"-PRIZREN jemi të interesuar të aplikojmë për grantin të cilin është duke u dhënë nga MZHR. Mirëpo kemi nevojë për disa sqarime. Biznesi jonë ka qarkullim mbi 15.000 euro dhe do të aplikojmë për pakon e aplikimi për LOT 3, (Biznes ekzistues). Ne do të aplikojmë për shumën 30.000 euro, mirëpo nuk e kemi të qartë sa është përqindja e bashkëfinancimit pasiqë ne udhezues është nga 10% deri në 40%. Ne këtë rast sa është përqindja që ne si biznes do të marrim pjesë në bashkëfinancim .

- *Shih përgjegjjen Nr.12.*

89. Unë e kam themeluar një biznes në Nëntor, 2019 (27/11/2019), si Sh.P.K. me adresë në Prishtinë. Ne këtë startup unë jam pronar/aksionar, 100%.

Deri këtë muaj qarkullimi shkon pak më shumë se 5,000 euro, kurse në dhjetor, 2019 kam pas të hyra rreth 670 euro.

Ju lutem më tregoni për cilin LOT mund të aplikoj? A i plotësoj kushtet për aplikim deri në shumën 15,000 euro?

- *Shih pikën 1.4 të udhëzuesit për aplikantë PZHRB 2020.*

90. Desha të pyes lidhur me grantet, përkatësisht për mënyrën e aplikimit të shumës, ku lot 3 shkruan deri në 30000 euro. A është bashkëfinancimi deri në 30000 euro apo unë mundem me kërku 5000 euro, 30000 euro mi dhan ju e pjesën tjetër ne si kompani.

- *Shih përgjegjjen Nr.12.*

91. Po ju shkruajm lidhur me: "Skema e Granteve „Programi i Zhvillimit Rajonal të Balansuar“ PZHRB 2020" LOT 3

Kemi dy pyetje:

- a. Ne kuader të LOT 3, po mendojmë të aplikojmë për vlerat maksimale, pra 30000 Euro grant, dhe 40% bashkëfinancim. Andaj Vlera total e projektit është:
- 50.000 Euro (30.000-60% dhe Bashkëfinancimi 20.000 -40%) apo
 - 42.000 (Ku pjesës se grantit prej 30.000 Euro i shtohet edhe 40%, pra edhe 12.000 Euro bashkëfinancim)
- *Shih përgjegjjen Nr.12.*
- b. Lidhur me shpenzimet e papranueshme, si psh shpenzimet e transportit. A munden këto shpenzime të vendosen në vlerën totale të projektit, por e cila do të mbulohet nga vet ndërmarrja përfituese e grantit, në kuadër të pjesës së bashkëfinancimit?
- *JO.*
92. Në aplikacionë për grande biznesi është hapur me 6 janar 2020 dhe ka filluar me punën , a kam të drejta aplikimi për grant dhe a duhet të aplikojë në cilën pikë sepse Makinat e qepjes disa i kam blerë vet me investime vetanake dhe disa shtes kam nevojë për ndihmë dhe a kam të drejtë të aplikojë edhe unë biznes.
- *PO.*
93. Po u shkruaj me qëllim që të marr sqarime dhe udhëzime rreth aplikimit për grante për shkak se po hasi në shumë problematika gjatë procesit të aplikimit. Po mendoj që të aplikoj si startup, a duhet që të bashkangjitet edhe planbiznesi për shkak se pashë tek platforma e aplikimit online që kërkohej vetëm pjesa financiare me pajisje. Përpos këtyre qv i përmenda më lartë, në përgjithësi po kemi vështërsi rreth aplikimit.
- *Për këtë thirrje duhet të plotësohet vetëm pako e aplikimi, (shih pikën 3.1 të udhëzuesit për aplikantë PZHRB 2020)*
94. Përshëndetje, i kam këto pyetje për Lot 2, jemi biznes aktiv për prodhimin e këpucëve
Lot 2:
- a. Si duhet të nënshkruajmë në fund për pranimin e të gjitha deklaratave, kur e gjithë procedura është online?
- *Vetëm deklarata e aplikantit Shtojca C1 duhet të nënshkruhet dhe të bashkangjitet.*
- b. ku thuhet kohëzgjatja e veprimit është 6 muaj, a është fjala për kohën e blerjes së makinerive, për rregullimin e vendit të punës etj?
- *Kohëzgjatja e veprimit nënkupton kohën e realizimit të projektit .*
95. Desha të bëjë një pyetje sa i përket aplikimit në grant .
A kanë të drejtë aplikimi në lotin 3 kompanitë të cilat kanë borxhe në ATK por të cilët kanë marrëveshje me ATK për shlyerje të borxhit me këste ?
- *PO.*
96. Jam e interesuar të aplikoj për Grantet 2020 që i ofron MZHR. Unë e kam regjistruar biznesin me 15.01.2020.
Pyetja ime është:
A duhet të aplikoj në LOT 1 Start up apo LOT 1 Biznes ekzistues, pasi që unë nuk kam histori tatimore për vitin 2019 në ATK meqë biznesi është regjistruar në janar 2020.
Tek LOT 1 Start UP e keni cekur që duhet të jenë biznese të peregjistruara.

- Tek cila duhet të aplikoj unë ?
- Nëse jeni biznes ekzistues duhet të aplikoni sipas kategorive të përcaktuara siç janë shpjeguar në udhëzuesin për aplikantë PZHRB 2020 pika 1.4. dhe 1.5.
97. Deshta te ju pyes, në lidhje me aplikimin për Grand 2020.
Unë tash se fundi para disa ditësh kam hapur një biznes të vogël, dje kam aplikuar për nr. fiskal mirëpo ende nuk kam përgjigje nga ARBK.
Për cilin llojë të grantit duhet të aplikoj (Loti 1 - Start Up, apo Loti a Ndërmarrje të mikro dhe të vogla)
- Nëse jeni biznes ekzistues duhet të aplikoni sipas kategorive të përcaktuara siç janë shpjeguar në udhëzuesin për aplikantë PZHRB 2020 pika 1.4. dhe 1.5.
98. Dhe te shtojca B1 buxheti, te shpenzimet a hyn shpenzimet për paisjet të cilat mbeshteten nga granti.
- PO, gjithashtu tek buxheti duhet të përfshihet edhe shuma e bashkëfinancimit.
99. Jam XXX nga Prishtina kam 2 pyetje rreth thirrjes për aplikime të Granteve 2020
- a.E kemi një kompani ekzistuese të regjistruar për shaka se ende jemi duke prit financim nga kredia ose grantet deri tash nuk kemi punë d.m.th nuk kemi pasur fare qarkullim, tash a ka mundësi që aplikimin ta bëjë si biznes ekzistues dhe pse nuk kemi pas qarkullim rrjedhimisht as nuk kemi paguar tatim. Te aplikimi për Lot 2 pjesën ku kërkohet qarkullimi vjetor 2019 t'a lëmë zbrazët.
- Qarkullimi vjetor ju kategorizon se në cilin Lot mund të aplikoni shih udhëzuesin për aplikantë PZHRB 2020 pika 1.4. dhe 1.5.
- b.Nëse makineria ndodhet jashtë vendit granti a i mbulon shpenzimet e transportit doganës dhe tvsh-së?
- JO.
100. Përshëndetje unë jam XXXX XXXX një pronar i XXXX kompanisë shërbyese të pastrimit dhe kemi si primare pastrimin e tepihave dhe deshta të di ne si kompani a mund të marrim pjesë në këtë grant pasi që kemi nevojë për makineri dhe për zgjerimin e biznesit dhe për punësim të punëtorëve.
- PO
101. Me respekt, Deri tek unë arriti informacioni për një donacion deri në 5000euro, po më intereson pasi që duam të aplikojm për atë mini projekt, cilat procedura apo aplikim dhe kujt t'i dorëzojë.
- Aplikimi bëhet përmes sistemit SMAED <https://smaed-online.rks-gov.net/> shih udhëzuesin për aplikantë në webfaqen e MZHR-së.

- Shëmbull i plotësimit të shtojcës së buxhetit B1

1. Buxheti

Shtojca B1 PZHRB 2020 (Lot 1 startup, Lot 1, Lot 2 dhe Lot 3)					
1. Buxheti për veprimin 1					
Nr.	Shpenzimet	Njësia	# i njësive	Vlera e njësisë (në EUR)	Shpenzimet e përgjithshme (në EUR)
1	Pajisjet dhe furnizimet				
1.1	Pajisja XXXX	copë	1	€ 15,500.00	€ 15,500.00
1.2					€ -
1.3					€ -
1.4					€ -
Shpenzimet e nën kategorisë: pajisje dhe furnizime					€ 15,500.00
2	Shpenzimet e tjera, shërbimet				
2.1	Shërbime të marketingut (XXXX)	copë	1	550	€ 550.00
2.2					€ -
2.3					€ -
2.4					€ -
Shpenzimet e nën kategorisë: të tjera, shërbime					€ -
3	Të tjera				
3.1					€ -
Shpenzimet e nën kategorisë: të tjera					€ -
Gjithësej shpenzime direkte të kualifikueshme për veprimin (1-3)					€ 16,050.00
1. Përshkrimi i njësive duhet të jetë mjaftueshëm i detalizuar dhe të gjitha njësitë duhet të jenë të zërthyera në përbërësit e tyre kryesor. Numri dhe vlera e njësive duhet të specifikohet për secilën njësi varësisht nga treguesi i ofruar. Buxheti duhet të përfshijë shpenzimet e lidhura me veprimin si tërësi, pavarësisht pjesës nga MZHR.					
NB: Përfutuesi (it) është përgjegjës për korrektësinë e informatave financiare të ofruara në këto tabela.					

2. Burimet e pritura te financimit

Shtojca B1 PZHRB 2020 (Lot 1 startup, Lot 1, Lot 2 dhe Lot 3)		
2. Burimet e pritura të financimit dhe përmbledhja e shpenzimeve të parapara		
	Shuma EUR	Përqindja %
Burimet e pritura të financimit		
Kontributi i MZHR-s i kërkuar me këtë aplikacion (A)	14300	
Kontributet tjera (aplikanti, donatorët tjerë, etj.) <i>Kushtet</i>	1750	
KONTRIBUTET TOTALE të pritura (B)	€ 16,050.00	
Shpenzimet e parapara		
SHPENZIMET E PËRGJITHSHME TË KUALIFIKUESHME të parapara (B)	€ 16,050.00	
Kontributi nga MZHR e shprehur si përqindje e shpenzimeve të përgjithshme të kualifikueshme (A/B x100)		89.10

Kontributi i MZHR-së i kërkuar

Kontributi i aplikantit

Vlera totale e projektit duhet të jetë e njëjtë me vlerën e tabelës A ku janë paraqitur pajisjet/shërbimet

Përqindja e financimit nga granti prej MZHR-së